



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1690/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, me seli në rr. ”Hazir Shala”, Nr. 4, në Prishtinë, kundër debitorit “Koleks” SH.P.K., me NUI: 810844466, me seli në rr. “Hekurudha”, në Prishtinë duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.516/23 të datës 24.07.2023, me datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me seli në Rr. ”Hazir Shala”, nr.4 në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 516/23 të datës 24.07.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar.KPPP.nr. 516/23 të datës 24.07.202, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Koleks” SH.P.K., me seli në Rr. “Hekurudha”, në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 107/22, i lejuar më datë 30.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Eset Murati SHFUQIZOHET.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, P.nr. 107/22, i lejuar më datë 30.03.2022, në bazë të dokumentit të besueshëm: Ekstraktit nga librat afarist Nr. 3914, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas ekstraktit të lartcekur, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrimit t'ia paguaj kreditorit borxhin prej 433.40 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Ndërsa, nëse debitori brenda afatit nuk e përmbush detyrimin e lartcekur, kreditori propozon që të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogaritjen e veçantë bankare të Zyrës Përmbartimore Eset Murati, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Kundër urdhrimit përmbartimor debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se në ekstrakt nuk është përfshirë pagesa në shumën prej 100.00 € e realizuar me datë 30.07.2021, ashtuqë shuma e kërkuar sipas këtij urdhri përmbartimor është më e madhe se obligimet e parapara. I ka propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor. Përgjigje në prapësim kreditori ka

paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, ngase në bazë të pasqyrës financiare të debitorit vlera e pagesës prej 100.00 € është regjistruar në databazën e kreditorit, gjithashtu debitori në baza mujore ka pranuar shërbimet e kreditorit për furnizimin e ujit dhe se deri më tani nuk i ka kundërshtuar këto shërbime. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit në tërësi si i pa bazuar si dhe të obligohet të paguaj obligimet e tij.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti Kartela Financiare e Konsumatorit Nr. 3914, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Ngase sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbartim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A, gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afarist. Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 3914, rezulton se borxhi në shumën prej 433.40 €, është kërkuar për periudhën kohore nga

data 01.01.2013 deri me datën 25.03.2023, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qartë se si dokument i besueshëm - kartela financiare e kontabilitet nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, sepse borxhi i cili rezulton në shumën prej 433.40 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 25.03.2023, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1690/23, me datë 25.03.2024

Gjyqtarja,

Franciska Zhitija Ymeri